



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANËS DURRËS

Nr. 2268 Prot.

Durrës, më 12 /02/2026

Lënda: Kërkesë për Shpallje Publike Publike



Drejtuar: DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE
DREJTORISË SË BURIMEVE MBËSHTETËSE

Në vijim të marrjes së masave për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor, mbështetur në Ligjin "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 të D.P.D-së "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës", Kreu VI "Njoftimi i Vendimit", pika 3, b) "Rastet e mos marrjes së konfirmimit të njoftimit", si dhe në zbatim të nenit 130-141/a të Kodit të Procedurës Civile, Ju drejtohem për të mundësuar njoftimin online/në faqen zyrtare të DPD-së, të subjektit/shtetasit debitor të poshtëshënuar pasi nga ana jonë nuk është mundësuar: **Njoftimi i Vendimit Administrativ të Degës së Doganës Durrës.**

Nr	Vendimi Administrativ		Subjekti debitor		Detyrimi	Penalitete	SHUMA
	Nr.	Data	Emri	Nipti			
1	165	09.02.2026	KRESKO GROU	Kosove	0	100,000	100,000

Ju falenderojmë për bashkëpunimin!

**KRYETARI
DENIS SHABANI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANËS DURRËS

Nr. 199 prot.

Durrës, më 09.02. 2026

VENDIM NR.165

(Lidhur me Vendimin nr.949/22432 Prot., datë 22.12.2025)

Sot, më datë 09.02.2026, unë, Kryetari i Degës së Doganës Durrës, pasi shqyrtova materialin e plotë bashkëlidhur emialin i datës 06.02.2026 (nr.2115 Prot., datë 09.02.2026) të Përgjegjësit të Sektorit Operacional Doganor si dhe Vendimin e Degës së Doganës Durrës me nr.949/22432 Prot., datë 22.12.2025;

U KONSTATUA SE:

Dega e Doganës Durrës në mbështetje të neneve 49, 70 e vijues, 169, 261 273 e vijues, 276 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor I RSH”, VKM-së nr.651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 ”Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe Procesverbalit të Verifikimit të Kundërvajtjes Doganore me nr.19059 Prot., datë 05.11.2025 të mbajtur të mbajtur nga ana e Sektorit të Operacioneve Doganore-Terminali i Kontejnerëve pranë Degës së Doganës Durrës, Urdhërit të Brendshëm nr.55/15735 Prot., datë 12.09.2025, mbajtur për kontenierët me nr. MEDU7709881 dhe nr.MSDU836888 të shoqërisë Kresko Group Kosovë me shoqërinë transportuese MSC Albania, Informacionit me nr.19059/1 prot., datë 05.11.2025 mbajtur nga Përgjegjësi i Sektorit të Operacioneve Doganor, ka vendosur:

1. Të sekuestrohet / konfiskohet sasia e mallit e ndodhur në:
 - **Në kontenierin me nr.MSDU8368880**
“ Artikulli dyer druri të brendshme pa kasa sasia 400 copë klasifikuar në KN *4418*;
Artikulli kasa për dyer të brendshme sasia 540 copë klasifikuar në KN *4418*;
Vlera e mallrave me qëllim sekuestrimi dhe kalim për procedurë ankandi është 4 149 727 lekë dhe detyrim doganor 829 945.40 lek”.
 - **Në kontenierin me nr.MEDU7709881**
“ Artikulli dyer druri të brendshme pa kasa sasia 400 copë klasifikuar në KN *4418*;
Artikulli kasa për dyer të brendshme sasia 540 copë klasifikuar në KN *4418*;
Vlera e mallrave me qëllim sekuestrimi dhe kalim për procedurë ankandi është 4 149 727 lekë dhe detyrim doganor 829 945.40 lek”.
2. Të penalizojë shoqërinë Kresko Group Kosovë dhe shoqërinë transportuese MSC Albania në masën 100 000 lek.
3. Dega e Doganës Durrës për rregullimin e situatës të marrë masa për;
Shitjen e tij nëpërmjet procedurës së ankandit parashikuar në Ligjin nr.9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik” i ndryshuar, të VKM-së me nr.1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e Rregullave të Ankandit Publik.

4. Dega e Doganës Durrës në rast të dështimit të procedurave të ankandit të marrë masa për dorëzimin e mallit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit,
5. Dega e Doganës Durrës në rast të refuzimit të mallit prej DPRMSH-së të marrë masa për; Tjerësimin / asgjësimin e tij në përputhje me dispozitat e Kodit Doganor, duke bashkëpunuar me Drejtorinë Rajonale të Mjedisit dhe Bashkinë Durrës në mbështetje të Ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar me Ligjin nr.156/2013, datë 29.10.2023 “Për disa ndryshime në Ligjin nr.10463, datë 22.09.2011”, të shkresave me nr.19936 Prot., datë 09.12.2011 “Mbi zbatimin e kuadrit ligjor për importimin e pajisjeve të përdorura në Republikën e Shqipërisë”, nr.7176 prot., datë 08.05.2012 “Mbi zbatimin e kuadrit ligjor për importimin e mbetjeve- goma të përdorura” të DPD-së.
6. Malli të qëndrojë pranë ambjenteve të magazinës së përkohëshme të Autoritetit Portual Durrës deri në përfundim të procedurave për dhënien e destinacionit doganor përfundimtar si dhe të bëhet njoftimi i tij.
7. Të njoftohet shoqëria Kresko Group Kosovë për të përballuar të gjitha shpenzimet që do të lindin deri në përfundim të procedurave për dhënien e destinacionit doganor përfundimtar.
8. Të njoftohet shoqëria MSC Albania në cilësinë e transportuesit të mallit në rrugë detare;
9. E tërë procedura të bëhet duke e vendosur mallin nën rregjimin doganor përkatës.
10. Për të proceduar më tej në zbatim të procedurave përkatëse të normuara nga aktet ligjore në fuqi ngarkohen Përgjegjësi i Sektori Operacional Doganor , Terminali i Kontejnerëve, Zyra e Financës, Zyra e Borxhit Doganor, Zyra e Magazinës këtu.
11. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në plotësim të kërkesave ligjore të neneve 281 e 282 të Kodit Doganor në fuqi (*kërkesa ankimore e arsyetuar duhet të paraqitet brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni të njoftimit të këtij vendimi, duke paguar shumën e përgjithshme të detyrimeve të importit/eksportit si dhe duke garantuar për DPD-në shumën e sanksioneve të aplikuara për këtë shkelje doganore*).
12. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Shoqëria Transportuese MSC Albania ka paraqitur ankim pranë Degës Doganore Durrës lidhur me penalitetin e vendosur në aktin e konstatimit nr.19059 prot., datë 05.11.2025 dhe në vijim mbas shqyrtimit të ankimit nga ana e Përfjegjësit të Sektorit Operacional Doganor është mbajtur emaili i datës 06.02.2026 (nr.2115Prot., datë 09.02.2026) duke arsyetuar faktin se shoqëria MSC Albania është vetëm në kushtet e shoqërisë transportit detar dhe jo subjekt që ka detyrimin për dhënie destinacioni.

Pjesa e pestë të Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” **Neni 98 Forma e aktit administrativ** parashikon se:

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, akti administrativ ka formë të shkruar në letër ose elektronike, verbale, ose çdo formë tjetër të përshtatshme.
2. Akti administrativ verbal konfirmohet në formë të shkruar në letër ose elektronike, kur pala e kërkon këtë menjëherë.
3. Organi publik është i detyruar të konfirmojë pa vonesë përmbajtjen e aktit verbal, në formë të shkruar në letër ose elektronike.
4. Konfirmimi, sipas pikave 2 dhe 3, të këtij neni, megjithëse nuk është akt administrativ, duhet të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 99 të këtij Kodi. 29

5. Aktet e organeve kolegjiale bëhen në formë shkresore. Këto akte regjistrohen në një procesverbal, pa të cilin ato nuk sjellin asnjë pasojë juridike.

Pjesa e gjashtë të Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” konkretisht **neni 144 ‘Rishikimi’** parashikon se;

‘ 1. Rishikimi është mjete ligjor administrativ, me anë të të cilit kërkohet anulimi apo ndryshimi i një akti administrativ të nxjerrë apo nxjerrja e një akti administrativ të refuzuar, kundër të cilit ankimi nuk është më i pranueshëm për shkak të kalimit të afatit të parashikuar nga ky Kod.

2. Pala mund të kërkojë rishikim, nëse zbulohen rrethana ose prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk dihen dhe mund të dihen prej saj gjatë zhvillimit të procedurës administrative që ka çuar në nxjerrjen e aktit administrativ’ .

Gjithashtu, **neni 146 ‘Vendimi për rishikimin’** parashikon se;

-Organi që ka nxjerrë ose ka refuzuar aktin administrativ, kur konstaton se akti administrativ ose refuzimi administrativ do të ishin të paligjshëm, nëse do të nxirrej në rrethanat aktuale mbizotëruese, përkatësisht e anulon aktin, e ndryshon atë, ose nxjerr aktin e refuzuar. Në rast të kundërt, rishikimi refuzohet.

Në përfundim, për sa më lart trajtuar, në mbështetje të Ligjit nr.102/2014 datë 31.07.2014 “Kodit Doganor të RSH” të ndryshuar, VKM nr.651, datë 10.11.2017 ”Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 ”Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr.44/2015 “Kodit të Procedurave Administrative” i ndryshuar, si dhe akteve ligjore dhe nënligjore në zbatim të tyre;

V E N D O S A :

1. Të saktësohet pika e 2 e Vendimit Administrativ me nr. 949/22432 Prot.,datë 22.12.2025 konkretisht si më poshtë vijon;
 - Shoqëria Kresko Group Kosovë të penalizohet në masën 100 000 lekë.
2. Të gjithë pikat e tjera të Vendimit nr. 949/22432 Prot.,datë 22.12.2025 mbeten të pandryshuara.
3. Për të proceduar më tej ngarkohen Përgjegjësi i Sektorit Operacional Doganor / Zyra Kontejnerëve, Zyra e Financës, Zyra e Borxhit Doganor, në zbatimin e procedurave përkatëse të normuara nga aktet ligjore në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Denis SHABANI

